



# **Diaspora e Kosovës dhe roli i saj në mes të krizave të shumta**



Diaspora e Kosovës dhe roli i saj në mes krizave të shumta

Raport Hulumtues

Mars 2023

*Ky publikim është porositur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, dhe është prodhuar nga GERMIN. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve, dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP-së.*

## Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje ekzekutive	1
<b>Historiku</b>	3
Objektivi i studimit	5
<b>Metodologjia</b>	5
Hartimi i mostrës	6
Mbledhja e të dhënave	6
Kontrolli i cilësisë dhe pastrimi i të dhënave	6
Kufizimet në studim	7
<b>Të gjeturat e anketës</b>	8
Rezultatet nga anketa me dërguesit e remitancave	8
Informata demografike	8
Remitancat: Kanalet e transfereve	11
Remitancat: Shpeshtësia dhe përdorimi	13
Remitancat: Mënyrat e transfereve dhe pritjet e ardhshme	16
Remitancat: Ndikimi i mundshëm i kushteve të jashtme në të ardhmen	19
Rezultatet nga anketa me pranuesit e remitancave	21
Informata demografike	21
Remitancat: kanalet, shpeshtësia dhe përdorimi i fondeve	24
Remitancat: Pritjet e ardhshme sipas kushteve të jashtme	28
<b>Rekomandimet</b>	30

## Tabela e figurave

### Anketë me dërguesit e remitancave

Figura 1. Gjinia	10
Figura 2. Grupmosha	10
Figura 3. Niveli i edukimit	10
Figura 4. Karakteristikat e ekonomive familjare	11
Figura 5. Profesioni i tanishëm	11
Figura 6. Të ardhurat personale dhe familjare	12
Figura 7. Vendi i banimit i të anketuarëve të disaporës	12
Figura 8. Koha e jetës jashtë Kosovës	13
Figura 9. Komunitat ku janë dërguar transferet e parave	13
Figura 10. Kanali kryesor që ju keni përdorur për të dërguar remitancat	14
Figura 11. Përparësitë e metodës së zgjedhur për transferet e parave	15
Figura 12. Shpeshtësia e transferit të remitancave	15
Figura 13. Marrëdhënia me pranuesit e remitancave	16
Figura 14. Shpeshtësia e transferit të parave sipas marrëdhënies me pranuesit e remitancave	16
Figura 15. Shuma e zakonshme sipas transferit të dërguar në remitanca	17
Figura 16: Përdorimi i remitancave nga pranuesi	17
Figura 17: A ka ndryshuar shuma e remitancave dërguar në Kosovë në gjashtë muajt e fundit?	18
Figura 18. Arsytet e ndryshimit të shumave monetare të remitancave të dërguara në gjashtë muajt e fundit	18
Figura 19. Arsytet për rritje të shumave monetare të remitancave të dërguara në gjashtë muajt e fundit	19
Figura 20. Në 6 deri në 12 muajt e ardhshëm, a prisni që shumat monetare të remitancave që ju i dërgoni të rriten/zvogëlohen?	20
Figura 21. Arsytet për pritjet që remitancat të rriten/zvogëlohen në 6 deri në 12 muajt e ardhshëm	20
Figura 22. Shuma e rritjes/zvogëlimit sipas pritjeve të rritjes/zvogëlimit të remitancave në 6 deri në 12 muajt e ardhshëm	21
Figura 23. Sa mendoni që ka mundësi që inflacioni/rritja e çmimeve do të ndikojë në shumat e remitancave që ju i dërgoni në Kosovë?	21
Figura 24. Sipas mendimit tuaj personal, sa mendoni që lufta në Ukrainë është duke ndikuar në rritjen e inflacionit/çmimeve?	22
Figura 25. Mendimet mbi ndikimin e inflacionit në remitancat e ardhshme, duke pasur parasysh përgjigjet se lufta në Ukrainë po ndikon shumë/deri diku në inflacion	23

## **Anketë me pranuesit e remitancave**

Figura 26. Gjinia	24
Figura 27. Grup mosha	24
Figura 28. Niveli i edukimit	24
Figura 29. Profesioni profesional	24
Figura 30. Karakteristikat e ekonomive familjare	25
Figura 31. Të ardhurat personale dhe familjare	25
Figura 32. Në cilën komunë të Kosovës jetoni?	26
Figura 33. Nga cili vend zakonisht i pranoni remitancat?	27
Figura 34. Sa shpesh pranoni remitanca?	27
Figura 35. Për sa kohë jeni duke pranuar remitanca nga jashtë vendit?	28
Figura 36. Kohëzgjatja e pranimit të remitancave të ndara sipas moshës	28
Figura 37. Çfarë marrëdhënie keni me personin/at që dërgon/jnë remitancat?	29
Figura 38. Kohëzgjatja e pranimit të dërgesave të ndara sipas marrëdhënieve me dërguesin e remitancave	29
Figura 39. Si i pranoni zakonisht këto fonde?	30
Figura 40. Për çka kryesisht i përdorni remitancat që i pranoni?	30
Figura 41. Në 6 deri në 12 muajt e ardhshëm, a prisni të merrni të njëjtën shumë monetare të remitancave nga jashtë vendit?	31
Figura 42. Sipas mendimit tuaj personal, sa mendoni se lufta në Ukrainë po ndikon në rritje të inflacionit/çmimeve?	31
Figura 43. Sa mendoni që ka mundësi se inflacioni/rritja e çmimeve të konsumit të përgjithshëm do të ndikojë në shumën monetare të remitancave që pranoni?	31
Figura 44. Sipas situatës aktuale ekonomike dhe politike, sa mendoni që faktorët e jashtëm do të ndikojnë (rritja e inflacionit/çmimeve, lufta në Ukrainë, etj.) në shumat e remitancave?	32

## Përmbledhje ekzekutive

Qëllimi i këtij studimi ishte të mblidhte përshtypjet nga dërguesit e remitancave nga diaspora dhe pranuesit e remitancave në Kosovë<sup>1</sup> lidhur me ndikimin e mundshëm të luftës në Ukrainë dhe inflacionit ekonomik në shumat e remitancave, duke u fokusuar në rrjedhat e parasë nga diaspora. Anketa është realizuar me gjithsej 198 dërgues të remitancave që jetojnë në vende të ndryshme, dhe 117 pranues të remitancave në Kosovë. Anketa u administrua në dy raunde, ndërmjet 5 - 30 shtator 2022, dhe 4-16 nëntor 2022, për të mbledhur të dhënat me interes.

Rezultatet tregojnë se më shumë se gjysma e dërguesve të remitancave në mostër, shumat e remitancave të dërguara në Kosovë është rritur në 6 deri në 12 muajt e fundit (2021/22), kryesisht për shkak të ndryshimit të kostove të jetesës ose gjendjes/të ardhurave financiare të anëtarëve të familjes/të afërmeve. Gjetje të tilla përputhen me ngjarjet e vitit të kaluar, pasi shpenzimet konsumatore u rritën pas pandemisë. Megjithëse shumë nga dërguesit e remitancave besojnë se shumata e transfereve të parave do të mbetet e njëjtë gjatë në 6-12 muajt e ardhshëm (46 përqind), rreth 38 përqind presin që shumata monetare e remitancave të rritet, krahasuar me 16 përqind që presin një rënie. Gjendja financiare e pranuesit fundor, ose ekonomia e dërguesit (nëse ata presin një rënie) janë arsytet. Shumica e të anketuarve besojnë se lufta në Ukrainë po ndikon në inflacion dhe se normat e larta të inflacionit do të ndikojnë në shumat e remitancave që ata dërgojnë në Kosovë. Ndërmjet pranuesve të remitancave, 60 përqind besojnë se shumata e remitancave do të mbetet e njëjtë në 6 deri në 12 muajt e ardhshëm, megjithëse fonde të tilla mund të ndikohen nga ndryshimet në kostot e jetesës ose nga situata financiare e dërguesve të remitancave dhe familjeve të tyre. Kjo përkon në të njëjtën kohë me 85% që besojnë gjithashtu se inflacioni do të ndikojë në sasinë e remitancave që ata pranojnë. Kështu, mund të shihet një mospërputhje e mundshme ndërmjet dërguesve dhe pranuesit fundor dhe pikëpamjeve të tyre, gjë që mund të ndikojë tek familjet në Kosovë.

Rekomandimet e mëposhtme dalin nga studimi. Së pari, dërguesit mendojnë se ka nevojë për të reduktuar koston e transfereve, pasi kjo do të bënte metodat më të shpejta dhe më të sigurta (p.sh., transferet bankare, operatorët e transferimit të parave online/offline). Andaj, është i nevojshëm bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet institucioneve qendrore dhe financiare për të ulur koston e

---

<sup>1</sup> Referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekst të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999)

transfereve. Së dyti, duhet të krijohen mundësi të qëndrueshme dhe të qarta investimi për diasporën, pasi shumica e remitancave aktualisht po përdoren për konsum. Përmes mundësive të zgjeruara të investimeve, diaspora mund të mbështesë krijimin e vendeve të punës, rritjen e produktivitetit dhe rritjen ekonomike. Duhet të krijohen mekanizma të rinj financiarë, siç është obligacioni i diasporës, dhe fokusi nuk duhet të jetë vetëm në tërë Kosovën, por edhe në nivel lokal dhe në komuna. Së treti, ekziston nevoja për të rritur “njohuritë” dhe transferimin e aftësive nga profesionistët e diasporës. Shumë nga dërguesit që morën pjesë në studim kishin një diplomë universitare, bizneset e tyre dhe aftësi që mund të paraqisnin një kontribut të vlefshëm. Duhet të krijohen platforma për të rritur transferimin e aftësive përmes programeve të ndryshme që do të inkurajonin anëtarët e diasporës për të kontribuar. Së katërti, duhet të studiohen masa për të zbutur uljen e mundshme të remitancave. Megjithëse pjesëmarrësit në studim janë mjaft të arsimuar, një numër i konsiderueshëm i të anketuarve kanë të ardhura të ulëta, dhe presin një të ardhme të luhatshme sa i përket remitancave. Skemat e ndihmës sociale apo masa të tjera institucionale për të zbutur ndikimin ekonomik të krizës. duhet të përdoren për mbështetje të synuar.

## Historiku

Krizat e shumta përgjatë disa viteve të fundit, duke filluar me pandeminë COVID që u shndërrua në një krizë socio-ekonomike, dhe më vonë, lufta në Ukrainë, kanë prishur ekonominë globale. Kriza e ardhur nga lufta në Ukrainë ka prekur rëndë zinxhirët e rëndësishëm të furnizimit, duke kontribuar në rritjen e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve që reflektohet në rritjen e normave të inflacionit. Vlerësimet e Eurostat tregojnë se norma vjetore e inflacionit në zonën e euros në dhjetor 2022 ishte 9.2 për qind.<sup>2</sup> Kontributi më i lartë në këtë normë inflacioni vjen nga energjia (25.7 përqind) e ndjekur nga ushqimet, alkooli dhe duhani (13.8 përqind) dhe mallrat industriale jo energjetike (6.4 përqind). Në Shtetet e Bashkuara, norma e inflacionit arriti në 9.1 përqind në qershor 2022, më e larta që nga viti 1981, megjithëse kohët e fundit është ngadalësuar në 6.5 përqind në dhjetor të vitit 2022.<sup>3</sup> Përpara vitit 2021 dhe krizës në Ukrainë, normat vjetore të inflacionit brenda BE-së dhe Shteteve të Bashkuara ishin të qëndrueshme në rreth 2 për qind. Fuqia e dobësuar blerëse pritet të ndikojë ndjeshëm në ekonominë globale, dhe sigurisht që do të ketë një ndikim të rëndë në ekonominë familjare me të ardhura të ulëta.

Duke pasur parasysh ndërlidhjen e lartë ekonomike të Ballkanit Perëndimor me ekonominë e përparuar në Bashkimin Evropian (BE), në Kosovë mund të pritet një rritje pasuese e çmimeve dhe një ngadalësim i rritjes ekonomike. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) vlerëson se niveli i inflacionit është rritur nga 0.1 përqind në fund të vitit 2020 në 11.6 përqind në nëntor të vitit 2022.<sup>4</sup> Ushqimet dhe pijet joalkoolike u rritën me rreth 18 përqind në nëntor (nga viti në vit deri në 2021), të ndjekura nga çmimet e banesave, ujit, energjisë elektrike, gazit dhe karburanteve të tjera (13.5 përqind).<sup>5</sup> BQK-ja parashikon një ulje të rritjes ekonomike në vitin 2022 në 3.3 përqind, nga 10 përqind në 2021, megjithëse pjesa më e madhe e rritjes së vitit të kaluar ishte ringjallje pas pandemisë.<sup>6</sup> Perspektiva për rritjen ekonomike në Kosovë mbetet e pasigurt përballë çmimeve të larta të energjisë, naftës dhe ushqimeve. Më e rëndësishmja, ndikimi i rritjes së normave të inflacionit në diasporën e konsiderueshme të Kosovës dhe rrjedhat e remitancave mbetet një rrezik negativ. Në vitin 2021, shumica e remitancave, turizmit dhe investimeve në pasuri të paluajtshme të

---

<sup>2</sup> <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/2995521/15725146/2-06012023-AP-EN.pdf/885ac2bb-b676-0f0d-b8b1-dc78f2b34735>

<sup>3</sup> <https://tradingeconomics.com/united-states/inflation-cpi>

<sup>4</sup> Banka Qendrore e Kosovës, Buletini Mujor Statistikor, Nr. 254, Dhjetor 2022, p.16

<sup>5</sup> Po aty., p.86

<sup>6</sup> Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Vlerësimi tremujor i ekonomisë, Nr.37, Q IV/2021, f.7-8



realizuara nga diaspora arriti në 39 për qind të BPV-së totale<sup>7</sup>, duke theksuar rëndësinë për ekonominë. Për të hetuar njëri nga pjesët, ky studim fokusohet në rrjedhat e remitancave duke anketuar dërguesit dhe pranuesit e remitancave nga diaspora.

Remitancat, të përkufizuara si: “*transfere financiare ndër personale, ndërkombëtare ndërmjet emigrantëve dhe familjeve të tyre dhe organizatave të shoqërisë civile në vendet e origjinës*”<sup>8</sup> arritën në 442 miliardë dollarë amerikanë globalisht në vitin 2020, shumica e të cilave shkojnë në vendet në zhvillim.<sup>9</sup> Remitancat përbëjnë prurjen më të madhe financiare në ekonominë e Kosovës, duke përfaqësuar rreth 18 për qind të BPV-së së Kosovës në vitin 2021.<sup>10</sup> Statistikat e fundit të BQK-së tregojnë se gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022, prurjet e remitancave arritën në 349.1 milionë euro, rreth 14 për qind më e lartë se në vitin 2021 (tremujori i tretë).<sup>11</sup> Shumica e remitancave vijnë nga diaspora e Kosovës që jeton në Gjermani (41.2 për qind), e ndjekur nga Zvicra (20.2 për qind), Shtetet e Bashkuara (9.1 për qind), Austria (5.6 për qind), Italia (5 për qind) dhe Franca (4 për qind).<sup>12</sup> Sipas një studimi të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, mbi 43 për qind e familjeve në Kosovë kanë të afërm që jetojnë jashtë Kosovës, dhe mbi 22 për qind e tyre pranojnë remitancat gjatë vitit.<sup>13</sup> Megjithatë, një problem i madh me remitancat është se ato përdoren kryesisht për konsum. Një tjetër anketë i fundit i kryer nga GERMIN, tregon se nga ata që marrin remitancat (të anketuarit mund të zgjidhnin disa kategori), kategoritë kryesore të shpenzimeve ishin për ushqim dhe veshje (84 për qind e rasteve), kujdes shëndetësor (62 për qind e rasteve), blerja e pronës<sup>14</sup> (46 për qind e rasteve), dhe vetëm në 17 për qind të rasteve, të anketuarit kanë pretenduar se i kanë përdorur remitancat për të hapur biznese të reja. Kjo është një mospërputhje me atë që dërguesit do të preferonin të përdoshin dërgesat si për shembull, 36% preferojnë që fondet të përdoren për hapjen e bizneseve të reja dhe 33% për qëllime shkollimi.<sup>15</sup> Si përfundim, prurjet financiare largohen me shpejtësi nga Kosova, pasi shumica e mallrave të

---

<sup>7</sup> Po aty., p.7

<sup>8</sup> Stephen Gelb et.al., “Financat e diasporës për zhvillim: nga remitancat në investim”, Komisioni Evropian, JRC Raporti Teknik, Luxemburg: Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian, 2021, f.6

<sup>9</sup> <https://data.worldbank.org/indicator/BX.TRF.PWKR.CD>

<sup>10</sup> <https://data.worldbank.org/indicator/BX.TRF.PWKR.DT.GD.ZS?locations=XK>

<sup>11</sup> Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Buletini Mujor Statistikor, Prill 2022, Nr. 248, f.96

<sup>12</sup> Banka Qendrore e Kosovës: Raporti Statistikor: <https://bqk-kos.org/statistikat/rreth-statistikave/>

<sup>13</sup> <https://ask.rks-gov.net/media/1712/remittance-2013.pdf>

<sup>14</sup> E rëndësishme të përmendet dallimi duke ju mundësuar anëtarëve të familjes në Kosovë për të blerë pronë, siç është rasti këtu dhe diaspora që investon në posedimin e vet pronës së tyre në Kosovë.

<sup>15</sup> Remitancat në Kosovë: Shuma të mëdha, diskutim i vogël, GERMIN, 2022

konsumit importohen, dhe përderisa remitancat luajnë një rol në uljen e varfërisë në Kosovë, ato kanë dështuar që të krijojnë punësim dhe të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Në përgjithësi, remitancat kanë qenë të qëndrueshme apo edhe janë rritur në kohë krize.<sup>16</sup> Sidoqoftë, rritja e shpejtë e normës së inflacionit ndikon drejtpërdrejtë në fuqinë blerëse të pranuesve dhe dërguesve të remitancave. Një studim tjetër i GERMIN zbulon se rreth 85 përqind e dërguesve të remitancave deklaruan se gjendja financiare e familjeve, miqve ose të afërmeve të tyre do të përkeqësohej nëse ata do të ndalonin dërgimin e remitancave.<sup>17</sup> Kjo është një shenjë shqetësuese pasi nivelet më të ulëta të remitancave të kombinuara me normat e larta të inflacionit dhe një ngecje potenciale ekonomike, mund të kthejnë prapa progresin ekonomik që është arritur deri më tani në Kosovë.

### Objektivi i studimit

Duke marrë parasysh që remitancat nga jashtë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të prurjeve financiare në Kosovë, dhe me kontekstin aktual ekonomik, ky studim mbledh informata dhe përshtypje të përgjithshme nga dërguesit dhe pranuesit e remitancave nga diaspora për të ardhmen e rrjedhave të remitancave. Studimi fokusohet vetëm në rrjedhat e remitancave, mjetet financiare private të dërguara nga diaspora (më së shpeshti) për anëtarët e familjes, në vend se tek investimet e udhëhequra nga diaspora, të cilat përfshijnë investime në portofol, kursime, pasuri të paluajtshme, biznese, apo një lloj tjetër investimi.

### Metodologjia

Instrumenti i hulumtimit ishte një pyetësor i strukturuar me fund të mbyllur, i kryer përmes një platforme online, për të cilin u deshën rreth 7 minuta për t'u plotësuar, me rreth 27 pyetje për secilin grup të synuar.

Anketa mblodhi informata demografike bazë për popullatën me interes, duke përfshirë modelet dhe metodat e transferimit të parave, sfidat dhe mundësitë për dërgimin e remitancave, rëndësinë e transfereve për familjet në Kosovë, dhe ndryshimet e mundshme në modelet e dërgimit të remitancave bazuar në kushtet e tregut në të ardhmen. Më e rëndësishmja, pyetësori mblodhi

---

<sup>16</sup> Po aty.

<sup>17</sup> Remitancat në Kosovë: Shuma të mëdha, diskutim i vogël, GERMIN, 2022

informata rreth mendimeve të banorëve të Kosovës dhe anëtarëve të diasporës, në lidhje me ndikimin e mundshëm të luftës në Ukrainë dhe normat e inflacionit në rrjedhat e remitancave.

Anketa përfshinte pyetje filtri për të dy grupet e synuara për të identifikuar popullatën me interes, duke përfshirë anëtarët e diasporës që dërgojnë remitanca dhe pranuesit e remitancave në Kosovë. Të anketuarit e tjerë që vizituan linkun e anketës, por u përgjigjën se nuk morën remitanca/ose dërguan remitanca jashtë vendit në 6 deri në 12 muajt e fundit, nuk u konsideruan si një popullatë e përshtatshme e synuar.

### Hartimi i mostrës

Popullat e synuar për këtë studim ishin (1) pjesëtarët e diasporës që dërgojnë remitanca në Kosovë, dhe (2) personat në Kosovë që kanë qenë pranues të remitancave, të paktën gjatë vitit të kaluar (2021/22). Për të trajtuar popullsinë me interes, GERMIN përdori grupin e anëtarëve të diasporës nga baza e të dhënave të saj, për të shpërndarë pyetësorët në internet në një grup të shpërndarë gjeografikisht. Anketa u promovua vazhdimisht përmes mediave sociale, e-mailave, buletineve dhe metodave të tjera online, dhe mblodhi përgjigje nga gjithsej

198 dërgues të remitancave dhe 117 pranues të remitancave.

### Mbledhja e të dhënave

Pyetësori është koduar në një platformë online. Pas testimit të anketës me rreth 25 të anketuar, ndryshimet e nevojshme në formulimin e pyetjeve u plotësuan në bazë të reagimeve të marra. Përgjigjet pilot u pastruan përpara se të fillonte shpërndarja e anketës.

Numri i pyetjeve dhe koha për të përfunduar sondazhin u konsiderua për të siguruar saktësinë e përgjigjeve, dhe dhënien e informatave të detajuara. Anketa u administrua online në dy runde: nga 5-30 shtator 2022 dhe nga 4-16 nëntor 2022, për të adresuar çështjen e mos përgjigjes dhe sfidave në arritjen e mostrës së dëshiruar. Sfidat dhe kufizimet e studimit diskutohen në pjesën e fundit të metodologjisë.

### Kontrolli i cilësisë dhe pastrimi i të dhënave

Për sondazhet online, pengesa zakonisht vjen nga përgjigjet me cilësi të dobët, të cilat mund të ndikojnë në vlefshmërinë e gjetjeve të studimit. Kontrolli i cilësisë u krye nga përgjigjet 'shënjuese' që kërkonin pastrimin e të dhënave për t'u siguruar që nuk kishte probleme. Kontrolli i cilësisë së pyetësorit u administrua në fund të çdo dite pune për të ndjekur çështjet e mundshme.

Pas përfundimit të mbledhjes së të dhënave, pastrimi i të dhënave është kryer për këto arsye: përgjigje të formuluar keq, të cilat erdhën për shkak të përgjigjeve të shpejta, përgjigje të parëndësishme që nuk përputheshin me pyetjet e bëra, gabime në përgjigjen e saktë dhe mungesë të të dhënave. Ky proces siguroi saktësinë e gjetjeve dhe, më e rëndësishmja, se anketa po arrinte grupin përkatës të synuar.

### Kufizimet në studim

Kur të merren parasysh gjetjet nga ky studim, është e rëndësishme të vihen në dukje disa sfida dhe kufizime. Sondazhet në internet zakonisht arrijnë një popullsi specifike, e cila është një lehtësi, dhe jo një mostër e rastësishme.

Zbatimi online i anketës paraqet një paragjykim të vetëpërzgjedhjes që kufizon përgjithësimet e rezultateve që në vend të kësaj bëhet tregues. Kjo do të thotë se ky anketë potencialisht mund të arrijë vetëm tek një nëngrup të popullatës me interes. Duhet të theksohet gjithashtu se mostra këtu nuk është përfaqësuese e popullatës me interes, veçanërisht kur bëhet fjalë për nivelin e arsimit. Për shembull, më shumë se gjysma e pranuesve të remitancave në mostrën tonë kanë një diplomë Bachelor, duke mos i kapur plotësisht ndjenjat e njerëzve me nivele më të ulëta arsimore që marrin remitanca.

Së dyti, tema e anketës mund të ketë dekurajuar individët që u mungon vetëbesimi që të shprehin mendimet e tyre rreth situatës ekonomike dhe politike në mbarë botën dhe pasojat e mundshme.

Së treti, anketa kërkoi informata personale në lidhje me kontaktet, të ardhurat dhe shpeshtësinë e transfereve të parave. Rrjedhimisht, kjo kufizon madhësinë e mostrës dhe popullsinë e synuar të arritur për shkak të shqetësimeve të privatësisë. Për të adresuar këtë çështje, GERMIN ndryshoi përputhshmërinë e kërkuar të informatave të kontaktit me e-mail në pyetësor, dhe rishpërndau pyetësorin në internet për një raund të dytë nga 4 deri më 16 nëntor 2022.

Duke pasur parasysh këto kufizime, paragrafi më poshtë paraqet gjetjet e anketës nga të dy grupet veç e veç, dërguesit e remitancave dhe pranuesit e remitancave në Kosovë.

## Të gjeturat e anketës

### Rezultatet e anketës me dërguesit e remitancave

#### Informata demografike

198 të anketuar e përfunduan sondazhin për dërguesit e remitancave. Pjesa e parë e anketës parashtronte pyetje demografike për të fituar njohuri rreth profilit të popullatës së synuar. Pyetësi u plotësua nga një përqindje pak më e lartë e meshkujve (59 përqind) krahasuar me femrat (41 përqind). Rreth 40 përqind e të anketuarve ishin të moshës 26-35 vjeç, pasuar nga 25 përqind e të anketuarve që ishin 36-45 vjeç, dhe 17 përqind raportuan se ishin 18 deri në 25 vjeç.

Figura 1. Gjinia






Figura 2. Grup moshë



Studimi zbuloi se 33 përqind e dërguesve të remitancave kishin një diplomë Bachelor, pasuar nga 21 përqind që kishin përfunduar vetëm shkollën e mesme. Mostra përbëhet nga rreth 17 përqind e të anketuarve me diplomë Master, së bashku me 15 përqind të të anketuarve me diplomë


universitare të pakryer. Vetëm rreth 2 përqind e dërguesve të remitancave kanë përfunduar një doktoraturë.

*Figura 3. Niveli i edukimit*




Në mesin e dërguesve të remitancave në këtë mostër, shumica (69 përqind) jetojnë me 2-4 anëtarë të familjes, ndërsa 16 përqind jetojnë me 5-7 anëtarë të familjes. Rreth 14 përqind e mostrës raportuan se jetonin vetëm.

*Figura 4. Karakteristikat e ekonomive familjare*




Shumica e dërguesve të remitancave në mostër janë të punësuar në biznese private (48 përqind), pasuar nga 17 përqind të cilët janë të vetëpunësuar apo që kanë një biznes, 12 përqind janë të punësuar në institucione publike, dhe rreth 7 përqind punojnë për organizata të ndryshme joqeveritare. Rreth 8 përqind e të anketuarve pohuan se nuk janë të punësuar aktualisht, dhe përqindja e njëjtë janë studentë.

Figura 5. Profesioni i tanishëm



Sa I përket të ardhurave personale, rreth 30 për qind e dërguesve të remitancave raportuan se fitonin nga 1001 deri në 2500 euro/muaj, e ndjekur nga 26 për qind që fitonin nga 2501-4000 euro/muaj, dhe 17 për qind e të anketuarve që fitonin nga 4001-5000 euro/muaj. Rreth 14 për qind e të anketuarve nga ky grup raportuan se fitonin më shumë se 5000 euro/muaj. Kur u pyetën për të ardhurat familjare, rreth një e treta e mostrës raportoi se kishte të ardhura familjare mbi 7,001 EUR/muaj. Rreth 27 për qind e të anketuarve pohuan se kishin të ardhura familjare prej 1501-4000 euro/muaj. Rreth 17 për qind fitojnë më pak se 1500 euro/muaj dhe megjithatë dërgojnë remitanca.


Figura 6. Të ardhurat personale dhe familjare



Rreth 40 përqind e mostrës së dërguesve të remitancave që përfunduan këtë anketë, raportuan se banonin në Gjermani, pasuar nga 20 përqind që jetonin në Mbretërinë e Bashkuar dhe 14 përqind


jetonin në Austri. Një pjesë më e vogël e të anketuarve jetojnë në Slloveni, Zvicër, Belgjikë dhe vende të tjera.

*Figura 7. Vendi i banimit i të anketuarve të diasporës*



Shumica e dërguesve të remitancave në mostër kanë jetuar jashtë vendit për më shumë se 15 vjet (rreth 47 përqind), pasuar nga 16 përqind që kanë qenë anëtarë të diasporës për një periudhë prej 5 deri në 10 vjet, dhe diaspora që jeton jashtë për 3-5 vjet (12 përqind).

*Figura 8. Koha e jetës jashtë Kosovës*




#### Remitancat: Kanalet e transfereve

Remitancat luajnë një rol të rëndësishëm për ekonominë familjare në Kosovë. Rreth një e katërta e të anketuarve pohuan se dërgojnë remitanca në komunën e Prishtinës (18 përqind), e ndjekur nga Prizreni (11 përqind) dhe Rahoveci (11 përqind), ndërsa një përqindje më e vogël raportoi se dërgon remitanca në komunat e tjera.




Figura 9. Komunat ku dërgohen transferet e parave



Metodat më të njohura të transferimit të parave për dërguesit e remitancave në mostër ishin paratë e gatshme kur vizitonin familjen (63 përqind), pasuar nga transferet përmes zyrave të operatorëve të parave si Moneygram, Western Union dhe të tjerë (47 përqind). Operatorët e transfereve të parave në internet dhe transferet bankare kishin më pak gjasa të zgjidheshin në rreth 20 dhe 18 përqind të rasteve, respektivisht.


Figura 10. Kanali kryesor që ju keni përdorur për të dërguar remitancat



Kur u pyetën për përparësitë e metodave të zgjedhura të përdorura për transferimin e parave në Kosovë, rezultatet tregojnë se dërguesit e remitancave vlerësojnë kohën dhe metodat e sigurta. Duke zbërthyer përgjigjet nga pyetja e mësipërme, me pyetjen që kërkon përparësitë e mundësive të zgjedhura të transferimit të parave, rezultatet tregojnë se më shumë se një e treta e të anketuarve që u përgjigjën se dërgojnë transfere parash kur vizitojnë familjen, pohuan se ata zgjidhin këtë metodë sepse e konsiderojnë më të shpejtë (34 përqind) dhe më të sigurtë (19 përqind).

Rezultate të ngjashme gjenden kur shikohet pjesa e të anketuarve që dërgojnë remitanca në para të gatshme përmes të afërmeve ose kompanive të transportit. Rreth 33 për qind e të anketuarve që dërgojnë para përmes transfereve bankare e konsiderojnë atë më të sigurtë, ndërsa 54 për qind e të anketuarve që dërgojnë remitanca përmes zyrave të operatorit të transferimit të parave (Moneygram, Western Union, etj.) zgjidhin këtë kanal sepse e konsiderojnë atë një metodë më të shpejtë.


Figura 11. Përparësitë e metodës së zgjedhur për transferet e parave



### Remitancat: Shpeshtësia dhe përdorimi


Rreth 22 për qind e të anketuarve kanë raportuar se dërgojnë remitanca në Kosovë çdo dy deri në katër muaj, pasuar nga 19 për qind që dërgojnë remitanca një herë në muaj, dhe 13 për qind që dërgojnë remitanca çdo dy muaj.

Figura 12. Shpeshtësia e transfereve të remitancave



Në shumicën e rasteve, anëtarët e diasporës dërgojnë transfere parash për prindërit (32 përqind), prindërit apo vëllezërit e motrat (23 përqind), prindërit, vëllezërit e motrat apo të afërmit (20 përqind), ose miqtë e tjerë të familjes (11 përqind).


Figura 13. Marrëdhënia me pranuesit e remitancave



Duke zbrërthyer të dhënat nga pyetja e mësipërme me shpeshtësinë e dërgimit të remitancave, rezultatet tregojnë se përzgjedhja më e shpeshtë për transferimin e parave, që është çdo pesë javë, ishte zakonisht për remitancat e dërguara prindërve (43 përqind e të anketuarve), pasuar nga prindërit, vëllezërit e motrat apo të afërmit (43 përqind). Në anën tjetër të spektrit, të anketuarit


pohuan se ata u dërgojnë remitanca miqve të tjerë të familjes një herë në vit ose vetëm në raste të veçanta.

Figura 14. Shpeshtësia e transferit të parave sipas marrëdhënies me pranuesit e remitancave




Edhe pse rreth 14 për qind e të anketuarve zgjedhën të mos e zbulojnë shumën e transferimit të parave, 26 për qind pretenduan të dërgonin 301-500 euro për transfer, pasuar nga 17 për qind që dërgojnë 100-200 euro, dhe një pjesë më e vogël e të anketuarve që dërgojnë 201- 300 euro remitanca (11 për qind). Rreth 9 për qind e dërguesve të remitancave në mostër raportuan se dërgojnë më shumë se 1,000 euro remitanca në Kosovë.

Figura 15. Shuma e zakonshme sipas transferit të dërguar në remitanca



Në shumicën e rasteve, dërguesit e remitancave nga ky anketë pohuan se përdorimi i fondeve të transferuara është për familjet/të afërmit e tyre për të blerë mallra dhe shërbime (66 për qind), pasuar nga pagesat për nevoja shëndetësore (46 për qind), për blerjen e pajisjeve shtëpiake (36 për qind), urgjencat (21 për qind), për të paguar shkollimin (15 për qind) dhe investimet/sipërmarrjen (10 për qind). Në më pak se 10 për qind të rasteve, të anketuarit raportuan se remitancat e dërguara në shtëpi përdoren për kursime apo qira dhe kosto banimi.


*Figura 16: Përdorimi i remitancave nga pranuesi*



#### Remitancat: Mënyrat e transfereve dhe pritjet e ardhshme


Në pyetjen nëse shumata monetare e remitancave të dërguara ka ndryshuar në gjashtë muajt e fundit, 43 për qind e të anketuarve thanë se kjo shumë është rritur, përkundrajt 41 për qind të atyre që kanë deklaruar se ajo shumë ka mbetur njëjtë. Për dallim, rreth 16 për qind e të anketuarve pohuan se shumata e remitancave të dërguara është ulur në gjashtë muajt e fundit.

*Figura 17: A ka ndryshuar shumata e remitancave dërguar në Kosovë në gjashtë muajt e fundit?*




Në pyetjen lidhur me arsyet e këtyre ndryshimeve, rreth 34 për qind e të anketuarve ia atribuon ndryshimin në shumën e transfereve të parave kostove të jetesës së anëtarëve/të afërmve që pranojnë transferet e parave apo ndryshimin në gjendjen financiare/të ardhurat e personave që pranojnë remitanca (20 për qind respektivisht).

Figura 18. Arsyet e ndryshimit të shumave monetare të remitancave të dërguara në gjashtë muajt e fundit




Duke zbërthyer të dhënat për grupin e të anketuarve të cilët më parë pohuan se shuma e remitancave të dërguara në Kosovë është rritur në gjashtë muajt e fundit (pyetja 17), arsyeja kryesore duket të jetë ndryshimi i kostove të jetesës apo gjendjes financiare të anëtarëve të familjes/ të afërmve që janë pranues të fondeve të tilla.

Figura 19. Arsyet për rritje të shumave monetare të remitancave të dërguara në gjashtë muajt e fundit




Rreth 46 për qind e të anketuarve presin që shuma monetare e remitancave që dërgohen në Kosovë të mbetet e njëjtë edhe në 6-12 muajt e ardhshëm, krahasuar me 38 për qind që besojnë se do të rrisin sasinë e parave, dhe 16 për qind që kanë deklaruar të kundërtën - se shuma në fakt do të ulet.

*Figura 20. Në 6 deri në 12 muajt e ardhshëm, a prisni që shumat monetare të remitancave që ju i dërgoni të rriten/zvogëlohen*




Për pjesën e të anketuarve që presin që shuma monetare e remitancave mund të ulet në 6 deri në 12 muajt e ardhshëm, arsyet kryesore ishin një ndryshim i pritshëm në kostot e tyre të jetesës (41 për qind), dhe ndryshimi i pritur në gjendjen e tyre financiare ose në të ardhurat (37 për qind). Nga ana tjetër, pjesa e të anketuarve që pretenduan se shuma e remitancave mund të rritet në 6 deri në 12 muajt e ardhshëm, raportuan se arsyet kryesore mund të jenë ndryshimet e pritshme në gjendjen financiare të personave të cilëve u dërgojnë remitanca (38 për qind), apo ndryshimi i pritur në kostot e tyre të jetesës (21 për qind).

Figura 21. Arsyet për pritjet që remitanca të rriten/zvogëlohen në 6 deri në 12 muajt e ardhshëm



Rreth 35 për qind e të anketuarve që presin një rritje të shumës monetare të remitancave të dërguara në Kosovë, pohuan se rritja për transfer do të jetë 101-300 euro, e ndjekur nga 33 për qind që pohuan se shuma mund të rritet me 50-100 euro për transfer, dhe 14 për qind që pohuan se shuma për transfer mund të rritet me më shumë se 1000 euro.

Figura 22. Shuma e rritjes/zvogëlimit sipas pritjeve të rritjes/zvogëlimit të remitancave në 6 deri në 12 muajt e ardhshëm




#### Remitancat: Ndikimi i mundshëm i kushteve të jashtme në të ardhmen

Sipas pritjeve në të ardhshmen dhe pyetjeve të deritanishme, të anketuarve iu kërkua të jepnin mendime mbi situatën e përgjithshme ekonomike dhe politike, dhe ndikimin e tyre në kushtet e tregut dhe rrjedhat e ardhshme të remitancave. Rreth 41 për qind e dërguesve të remitancave nga ky anketë besojnë se inflacioni ka më shumë gjasa të ndikojë në remitancat e dërguara në Kosovë, pasuar nga 36 për qind që besojnë se kjo ka shumë gjasa të ndodhë. Përkundrazi, rreth 14 për qind e të anketuarve besojnë se nuk ka gjasa ose nuk ka shumë të ngjarë që inflacioni të ndikojë në prurjen e remitancave që ata dërgojnë në Kosovë.




Figura 23. Sa mendoni që ka mundësi që inflacioni/rritja e çmimeve do të ndikojë në shumat e remitancave që ju i dërgoni në Kosovë?




Në përfundim, të anketuarve iu kërkua të jepnin mendime nëse besojnë se lufta në Ukrainë po ndikon në rritjen e çmimeve të përgjithshme/inflacionit. Rezultatet tregojnë se shumica e dërguesve të remitancave nga ky anketë besojnë se lufta në Ukrainë po ndikon shumë në inflacion/rritje të çmimeve (64 për qind), rreth një e katërta që po ndikon deri dikudisi (26 për qind), dhe një pjesë e vogël u deklarua të mos jenë të informuar (7 për qind).

Figura 24. Sipas mendimit tuaj personal, sa mendoni që lufta në Ukrainë është duke ndikuar në rritjen e inflacionit/çmimeve?



Nga grupi i të anketuarve që pohuan se lufta në Ukrainë po ndikon shumë dhe deri diku në inflacion, shumica dërrmuese besojnë se inflacioni do të ndikojë në shumat e remitancave që ata dërgojnë në Kosovë, për dallim nga rreth 22 për qind e të anketuarve që nuk mendojnë se ka shumë të ngjarë që inflacioni të ndikojë në shumën e remitancave.

Figura 25. Mendimet mbi ndikimin e inflacionit në remitancat e ardhshme, duke pasur parasysh përgjigjet se lufta në Ukrainë po ndikon shumë/deri diku në inflacion



## Rezultatet nga anketa me pranuesit e remitançave

### Informata demografike

Mostra për pjesën e dytë të studimit përbëhet nga 117 të anketuar – persona në Kosovë që pranojnë remitanca nga anëtarët e familjes/të afërmit në diasporë. 58 për qind e të anketuarve në këtë pjesë të anketës ishin femra, dhe 42 për qind ishin meshkuj. Shumica e mostrës raportuan se ishin 26-35 vjeç (40 përqind), e ndjekur nga 18-25 vjeç (32 përqind) dhe 36-45 vjeç (15 përqind).

Figura 26. Gjinia






Figura 27. Grup mosha




Sa i përket nivelit të arsimit, pothuajse gjysma e mostrës raportoi të ketë një diplomë Bachelor, e ndjekur nga 33 përqind që kanë një diplomë master, dhe rreth tre përqind që kanë doktoraturë ose më lartë. Rreth 14 përqind e mostrës raportuan se nuk i kishin përfunduar studimet e tyre universitare.

Figura 28. Niveli i edukimit




Shumica e pranuesve të remitancave në mostër punojnë për biznese private, pasuar nga 20 për qind që punojnë për institucione publike, dhe 16 për qind që punojnë për organizata joqeveritare me seli në Kosovë. Rreth 11 për qind e të anketuarve janë të vetëpunësuar/pronarë biznesi, dhe 15 për qind kanë raportuar të jenë aktualisht të papunë.

*Figura 29. Profesionit profesional*




Duke parë karakteristikat e ekonomisë familjare, shumica e të anketuarve raportuan se jetojnë me 2 deri në 4 anëtarë të familjes (44 përqind), të ndjekur nga 39 përqind që jetojnë me 5 deri në 7 anëtarë të familjes. Rreth 13 për qind e të anketuarve në këtë anketë që pranojnë remitanca kanë raportuar se jetojnë vetëm.

*Figura 30. Karakteristikat e ekonomive familjare*




Në pyetjen për të ardhurat personale dhe familjare, duke përfshirë remitancat, rreth një e katërta e të anketuarve në këtë anketë raportuan të ardhura prej 301-500 euro/muaj, pasuar nga ata që raportuan të ardhura prej 701-1,000 euro/muaj (15 përqind). Megjithatë, rreth 22 për qind deklaruan të ardhura më pak se 300 euro/muaj. Duke parë të ardhurat familjare, rreth një e katërta e përqindjes së mostrës së të anketuarve pohuan se kishin të ardhura familjare në një shtrirje prej 1,001-1,500 EUR/muaj, të ndjekur nga ata që raportuan se kishin të ardhura familjare prej 701-1,000 EUR/muaj (22 përqind ). Rreth 10 përqind e të anketuarve pohuan se të ardhurat e tyre familjare janë më pak se 500 euro/muaj.

*Figura 31. Të ardhurat personale dhe familjare*



Rreth një e katërta e të anketuarve jetojnë në Prishtinë, pasuar nga Suhareka (12 përqind), Gjilani dhe Prizreni (11 përqind secili), Mitrovica (5 përqind), Ferizaj (7 përqind) dhe pjesa tjetër jetojnë në komunitat e tjera.

Figura 32. Në cilën komunë të Kosovës jetoni?




### Remitancat: kanalet, shpeshhtësia dhe përdorimi i fondeve

Remitancat janë një burim shumë i rëndësishëm i të ardhurave për ekonomitë familjare në Kosovë. Rreth 40 për qind e të anketuarve raportuan se nuk do të ishin në gjendje të mbulonin nevojat elementare të familjes pa këto këto fonde. Pjesa vijuese e raportit ofron më shumë njohuri në lidhje me remitancat e pranuar dhe sfidat në të ardhmen.

Shumica e pranuesve të remitancave në mostër pranojnë fonde nga anëtarët e familjes/të afërmit që jetojnë në Gjermani (58 përqind), Zvicër (26 përqind), Austri (13 përqind), Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar (rreth 10 përqind secili) dhe të tjerët nga vendet e tjera.


Figura 33. Nga cili vend zakonisht i pranoni remitancat?



Rreth një e treta e të anketuarve pohuan se pranojnë remitanca çdo dy deri në katër muaj, dhe rreth 17 përqind raportuan se pranojnë remitanca një herë në vit. Rreth 15 për qind pohuan se merrnin


të ardhura të tilla shtesë vetëm për nevoja të veçanta që mund të shfaqen në familje, dhe një pjesë më e vogël raportoi se pranon remitanca çdo gjashtë muaj.

*Figura 34. Sa shpesh pranoi remitanca?*




Më shumë se 35 për qind e të anketuarve raportuan se kishin pranuar remitanca për më shumë se pesë vjet, ndërsa 29 për qind u përgjigjën se kishin pranuar remitanca vetëm vitin e kaluar.

*Figura 35. Për sa kohë jeni duke pranuar remitanca nga jashtë vendit?*




Duke i zbërthyer të dhënat sipas periudhës së pranimit të remitancave, rezultatet tregojnë se një pjesë më e madhe e të anketuarve në grup moshën 36-45 vjeç, 46-55 vjeç dhe 56-65 vjeç kanë pranuar remitanca për më shumë se pesë vjet. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve kanë filluar të pranojnë remitanca gjatë vitit të kaluar, veçanërisht në grup moshën prej 26 deri në 35 vjeç.

Figura 36. Kohëzgjatja e pranimit të remitancave të ndara sipas moshës



Rreth gjysma e të anketuarve pretenduan se pranojnë remitanca vetëm nga një person, ndërsa gjysma tjetër pohuan se pranojnë remitanca nga dy ose më shumë persona që jetojnë në diasporë. Në shumicën e rasteve, të anketuarit pohuan se zakonisht pranojnë remitanca nga vëllai ose motra e tyre që banon jashtë vendit (61 përqind), pasuar nga kushërinjtë që jetojnë në diasporë (15 përqind) dhe nga prindërit (13 përqind). Shuma mesatare e transfereve të parave është raportuar të jetë 557 euro, në një shkallë prej 10 deri në 10,000 euro.


Figura 37. Cila është marrëdhënia juaj me personin/at që ka/në dërguar remitancat?



Rreth 39 përqind e të anketuarve që kanë pohuar se vëllezërit e motrat e tyre dërgojnë remitanca kanë raportuar se i kanë pranuar këto fonde për më shumë se pesë vjet, ndërsa 27 përqind e të


anketuarve kanë filluar të pranojnë remitancat në vitin e kaluar. Në krahasim, kohëzgjatja e remitancave për të anketuarit që marrin fonde nga kushërinjtë është më e shkurtër.

*Figura 38. Kohëzgjatja e pranimit të remitancave e zbërthyer sipas marrëdhënies me dërguesin e remitancave*



Dy nga metodat më të zgjedhura për pranimin e transfereve të parave të raportuara, ishin paratë e gatshme të dorëzuara personalisht gjatë vizitës në shtëpi të anëtarit të familjes (56 përqind) dhe transferet bankare (42 përqind). Rreth 26 përqind e të anketuarve pohuan se përdorin operatorë të transfereve financiare për të pranuar fonde nga jashtë, dhe më pak se 10 përqind pranojnë para të gatshme përmes të afërmeve të tjerë ose kompanive të transportit.

*Figura 39. Si i pranoni zakonisht këto fonde?*




Rreth 87 përqind e të anketuarve pohuan se remitancat janë shumë të rëndësishme për mbulimin e shpenzimeve dhe nevojave familjare në ekonominë familjare të tyre. Në shumicën e rasteve, remitancat përdoren për blerjen e mallrave dhe shërbimeve (64 përqind), për blerjen e pajisjeve shtëpiake (38 përqind), për pagesën e nevojave shëndetësore (27 përqind) dhe për shkollim (26



për qind), për investime/sipërmarrje (21 për qind) dhe nevoja të tjera, urgjencat ose kursimet për shpenzimet e ardhshme.


*Figura 40. Për çka kryesisht i përdorni remitancat që i pranoni?*



#### Remitancat: Pritjet e ardhshme sipas kushteve të jashtme

Shumica e pranuesve të remitancave në studim nuk presin ndonjë ndryshim në 6 deri në 12 muajt e ardhshëm për sa i përket fondeve që do t'i pranojnë nga jashtë. Megjithatë, rreth 40 për qind e të anketuarve besojnë se një ndryshim i mundshëm në gjendjen financiare të anëtarit të familjes/të afërmit që dërgon remitanca mund të ndikojë në shumën e fondeve të pranuar. Në mënyrë të ngjashme, edhe ndryshimet e pritshme në kostot e jetesës së personit që dërgon remitancat do të mund të ndikonin në prurje.


*Figura 41. Në 6 deri në 12 muajt e ardhshëm, a prisni të merrni të njëjtën shumë monetare të remitancave nga jashtë vendit?*




Pothuajse të gjithë të anketuarit besojnë se lufta në Ukrainë po ndikon në inflacion dhe në rritjen e çmimeve. Rrjedhimisht, rreth 85 përqind e të anketuarve besojnë se inflacioni do të ndikojë në

shumën monetare të remitancave që ata pranojnë zakonisht, për dallim nga rreth 8 përqind që nuk e shohin këtë si të mundshme/shumë të mundshme.

*Figura 42. Sipas mendimit tuaj personal, sa po ndikon lufta në Ukrainë në rritje të inflacionit/çmimeve?*




*Figura 43. Sa ka mundësi që inflacioni/rritja e çmimeve të konsumit të përgjithshëm të ndikojë në shumën monetare të remitancave që pranoi?*



Sa i përket situatës aktuale ekonomike dhe politike të krijuar si rezultat i luftës në Ukrainë, pikëpamjet janë deri diku të ndara. Përderisa rreth 43 përqind besojnë se këta faktorë të jashtëm mund të mos kenë një ndikim të madh në shumën monetare të remitancave që zakonisht pranojnë nga jashtë, më shumë se gjysma kanë pikëpamje të kundërta dhe besojnë se ngjarje të tilla do të kenë një efekt negativ.

*Figura 44. Sipas situatës aktuale ekonomike dhe politike, sa mendoni që faktorët e jashtëm do të ndikojnë (rritja e inflacionit/çmimeve, lufta në Ukrainë, etj.) në shumën e remitancave?*



## Rekomandimet


Ky studim zbulon disa gjetje interesante të cilat mund të shpjegohen më tej nga një varg organesh institucionale për të rritur angazhimin e diasporës në Kosovë dhe gjithashtu për të zbutur uljen e mundshme të remitancave.

- **Zvogëlimi i kostove të transferit të parave** – Të hyrat e remitancave janë një komponent i rëndësishëm i llogarisë rrjedhëse në Kosovë. Ky studim zbulon se për dërguesit e remitancave është e rëndësishme që të kanalizohen fondet përmes metodave të shpejta dhe më të lira të transfereve të parave. Një bashkëpunim më i mirë ndërmjet institucioneve qendrore dhe institucioneve financiare për të përmirësuar dhe bërë pagesat ndërkufitare më të qasshme dhe për të nxitur integritetin e sistemeve të transferit të parave, do të ndihmonte në rritjen e shpeshtësisë së rrjedhave të tilla. Kjo do të kërkonte reforma të politikave dhe përmirësime teknike që do të synonin të lehtësonin transferin e fondeve nga diaspora në Kosovë.
- **Krijimi i mundësive për investim për diasporën** - Ky studim u përqendrua në rrjedhat e remitancave, domethënë mjetet financiare të ofruara për anëtarët e familjes, duke përjashtuar investimet. Rezultatet treguan se shumica e këtyre mjeteve përdoren për konsum të mallrave dhe shërbimeve. Komunitetet e diasporës mund të jenë një forcë e dobishme për zhvillim në vendet e origjinës duke rritur kapitalin financiar, dhe rrjedhimisht nxitur krijimin e vendeve të punës, produktivitetin dhe rritjen më të lartë. Në Kosovë, ekziston nevoja për bashkëpunim ndërmjet organeve institucionale për të tërhequr angazhimin e diasporës në aspektin e investimeve kapitale. Kjo mund të arrihet duke lehtësuar barrierat ligjore dhe kufizimet e rrjedhës së kapitalit me të cilat përballen anëtarët e diasporës kur për shembull blejnë pronën e tyre dhe investojnë në mundësi biznesi.
  - *Futja e mekanizmave të rinj financiarë për të kanalizuar kapitalin financiar të diasporës në investime*

Tërheqja e investimeve nga diaspora nuk nënkupton vetëm organizimin e konferencave apo promovimin e mundësive në terren. Futja e mekanizmave të rinj financiarë si obligacionet (letrat me vlerë), apo garantimi i kapitalit sipërmarrës ose fondeve të kapitalit privat, ka potencialin për të nxitur më tej investimet e diasporës.

Futja e obligacioneve të diasporës përbën një hap të rëndësishëm në këtë drejtim. Megjithatë, ka hapësirë dhe mundësi për të mbështetur zhvillimin e fondeve private të investimeve me kapital nga diaspora. Sidoqoftë, është e rëndësishme që përveç fokusit mbarë kosovar, të ketë edhe lidhje edhe në nivelin lokal dhe me komunitetin pasi edhe ato kanë nevojë për investime për të përparuar.

- **Njohuritë dhe transferimi i aftësive** - Niveli i arsimit për më shumë se gjysmën e dërguesve të remitancave në këtë anketë ishte i nivelit universitar dhe më i lartë. Për më tepër, 17 për qind janë pronarë biznesesh dhe rreth 48 për qind kanë raportuar se punojnë në biznese private jashtë vendit. Roli i diasporës në zhvillim shkon përtej remitancave dhe investimeve për shkak të aftësive të tyre profesionale dhe teknike që mund të jenë një kontribut i çmuar për Kosovën. Kjo paraqet nevojën për zhvillimin e një platforme shumë-funksionale në Kosovë për të krijuar mundësi për transferimin e njohurive dhe aftësive teknike përmes programeve të ndryshme që do të inkurajonin anëtarët e diasporës për të kontribuar. Aktualisht, ka mungesë të angazhimit profesional të diasporës nëpër sektorë të ndryshëm në Kosovë, si arsimi, shëndetësia dhe ndërmarrësia. Iniciativat e organizatave joqeveritare gjithashtu duhet të mbështeten në krijimin e më shumë programeve të tilla që do të mundësonin transferimin e ekspertizës së diasporës në njohuri dhe aftësi.
- **Lehtësimi i uljes së mundshme të remitancave për shkak të krizës** - Duket se ka një mospërputhje në pritjet e dërgesave të ardhshme ndërmjet dërguesve dhe pranuesve. Në studim, 22% e pranuesve kanë të ardhura personale nën 300 euro/muaj, dhe 10% kanë të ardhura familjare më pak se 500 euro/muaj. Me një arsim relativisht të lartë në mesin e të anketuarve që janë pranues të remitancave në këtë raport, kjo është vetëm maja e një akullnaje. Të anketuarit presin që lufta në Ukrainë dhe inflacioni të ndikojë në atë se sa të holla dërgohen/pranohen. Duhet të ketë një hulumtim për masat lehtësuese për t'iu përgjigjur ndikimit potencial negativ ekonomik që mund t'i prek familjet që jetojnë afër kufirit të varfërisë.



# **Diaspora e Kosovës dhe roli i saj në mes të krizave të shumta**

**Mars 2023**